



BASHKIA MIRDITË

Nr. 917 Prot.

Datë 06. 03. 2023

V E N D I M

Nr. 16, datë 06. 03. 2023

"PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TE PLANIT TË DETYRUAR VENDOR (PDyV), PËR ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja "b" dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 97/2019 "Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore", të Vendimit Nr. 469, datë 10.06.2020 "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese", të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Miratimin e Rishikimit te Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:

Materiali hartografik:

- a. Plani I Detyruar Vendor I Zones se Re per Zhvillim (I rishikuar) ne Territorin e Bashkise Mirdite (PDF, DWG, GIS).
- b. Skema e apartamenteve dhe banesave kolektive.

2. Miratohet rindërtimi I plote, në Zonën e Re për Zhvillim, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, me qëllim rindërtimin e objekteve të cilat referuar aktekspertizës së thelluar dhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim,, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.

4. Plani i Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, të integrohet me Planin e Përgjithshëm Vendor në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar.

5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI
NDREC DEBAJ

